



KOMUNA E PRISHTINËS
RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Kadastrit
Periudha raportuese	Mars 2017
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Nora Kelmendi, drejtoreshë e Drejtorisë së Kadastrit

1. PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Drejtoria e Kadastrit - Zyra kadastrale komunale (ZKK) e Prishtinës, ka vazhduar të bëjë ofrimin e shërbimeve sa me efikase për qytetarë, duke ofruar informacione dhe të dhëna të azhurnuara për pronat e paluajtshme.

Gjatë muajit mars 2017, në 6 zyrat pritëse janë pranuar gjithësejt **4,468** kërkesa, nga të cilat janë miratuar **4,321** kërkesa, refuzuar **19** dhe kanë mbetur në procedurë edhe **132** kërkesa, të cilat janë realizuar përmes 2 sektorëve: Sektorit të kadastrit dhe Sektorit të gjeodezisë.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA - Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara sipas planprogramit të Komunës për drejtorinë tuaj.

Aktivitetet e planifikuara të Drejtorisë së Kadastrit janë:

- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim të pronësisë;
- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim dhe çregjistrim të hipotekës;
- Shqyrtimi i kërkesave për përmirësim të regjistrave kadastrale;
- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim të banesave;
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve;
- Shqyrtimi i kërkesave për ndarje të pronësisë, parcelave;
- Shqyrtimi i kërkesave për dhënie të produkteve (koordinatave);
- Shqyrtimi i kërkesave për bashkim të parcelave;
- Shqyrtimi i kërkesave për identifikimin e njësive banesore;

- Shqyrtimi i kërkesave për përcaktim dhe rirregullim kufiri;
- Shqyrtimi i kërkesave nga gjeodetët dhe kompanitë e licencuara;
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve.

3. *AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtorja juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë.*

Në Drejtorinë e Kadastrit gjatë muajit mars 2017, nëpërmes zyreve pritëse dhe Sektorit të kadastrit dhe Sektorit të gjeodezisë, janë pranuar kërkesa të ndryshme.

Në Sektorin e kadastrit janë përpunuar kërkesat në vijim:

- 346 kërkesa për regjistrim të pronësisë, prej të cilave janë miratuar 258, kemi refuzuar 15 kërkesa për regjistrim të pronësisë, ndërsa janë njoftuar palët në procedurë me 73 konkluzione, duke u pezulluar procedura deri në plotësimin e lëndëve me dokumentacione përkatëse;
- 26 kërkesa për historik nga persona fizikë, institucione, prej të cilave janë miratuar 26 dhe asnjë lëndë nuk ka mbetur në procedurë;
- 236 shkresa / kërkesa nga institucionet e ndryshme, ku janë realizuar të gjitha;
- 58 kërkesa për përmirësime, nga të cilat janë miratuar 47, janë refuzuar 3 dhe 8 janë në procedurë;
- Nuk kemi pranur asnjë kërkesë për regjistrim të barrës tatimore e cila është aprovuar;
- 72 kërkesa për regjistrim të hipotekave, të gjitha të miratuara dhe 65 kërkesa për çregjistrim, nga të cilat janë aprovuar të gjitha dhe asnjë nuk ka ngelur në procedurë.

Numri i përgjithshëm i kërkesave të pranuar për këtë sektor ka qenë: 803, nga të cilat 704 kërkesa janë miratuar, 18 janë refuzuar dhe 81 kërkesa kanë ngelur në procedurë.

Në Sektorin e gjeodezisë janë përpunuar kërkesat në vijim:

- 2,052 kërkesa për certifikata të pronësisë dhe 1,233 kërkesa për kopje të planit, që d.m.th. janë pranuar dhe realizuar gjithsej 3,285 kërkesa;
- 28 kërkesa për ndarje të pronësisë, nga të cilat 22 janë miratuar dhe 6 kanë ngelur në procedurë për shqyrtim;

- 13 kërkesa për incizimim të ndërtesave, banesave, nga të cilat 7 janë miratuar, është refuzuar 1 kërkesë dhe 5 kanë ngelur në procedurë për shqyrtim;
- 19 kërkesa për bashkim të parcelave, nga të cilat janë miratuar 14 dhe 5 kanë mbetur në procedurë;
- 66 kërkesa për dhënien e produkteve (koordinatave), të gjitha të realizuara;
- 66 kërkesa për identifikimin e parcelave dhe njësisive banesore, nga të cilat 67 janë miratuar dhe në procedurë kanë ngelur edhe 3 kërkesa;
- 16 kërkesa për përcaktim dhe rirregullim kufiri, nga të cilat janë miratuar 11 dhe në procedurë janë 5;
- 2 kërkesa për ndërrim kulture, të shqyrtuara dhe të miratuara;
- 120 kërkesa nga gjeodetët dhe kompanitë e licencuara, nga të cilat janë miratuar 100 dhe 20 kanë mbetur në procedurë për shqyrtim;
- 40 kërkesa zyrtare nga institucionet e ndryshme, nga të cilat janë miratuar 33 dhe 7 kanë ngelur në procedurë.

Numri i përgjithshëm i kërkesave të pranuarra për këtë sektor ka qenë: 3,665, nga të cilat 3,617 kërkesa janë miratuar, 1 është refuzuar dhe 51 kërkesa kanë ngelur në procedurë.

Nga të dhënat e lartshënuara shihet se Drejtoria e Kadastrit ka realizuar rreth **90** për qind (%) të planit, duke i miratuar, refuzuar apo pezulluar kërkesat e palëve në procedurë sipas shqyrtimeve ligjore që ka bërë lidhur me këto kërkesa.

E arritur e Drejtorisë së Kadastrit është se në afatin e përcaktuar ligjor prej 15 ditëve, ka arritur të nxjerrë vendime meritore për secilën prej kërkesave të parashtruara nga palët /subjektet juridike.

4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR - Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.

Aktivitetet që janë në implementim e sipër nga Sektori i kadastrit:

- Lëndët në shpallje publike në afat prej 5 ditësh pune, që kanë të bëjnë me regjistrimin e pronës së paluajtshme në operatin kadastral;
- Lëndët e dërguara në KPA, verifikim dhe pëlqime për regjistrim të banesave;
- Lëndët e dërguara për verifikim në gjykata, Arkiv Komunal ose Nndërkomunal.

Aktivitetet që janë në implementim e sipër nga Sektori i gjeodezisë:

- Lëndët për ndarje, identifikim dhe bashkim të parcelave;
- Lëndët për identifikimin e njësive banesorë;
- Lëndët për kërkesa zyrtare dhe kërkesa nga institucionet.

4.1.1. STATISTIKAT

Të listohen të gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika të tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës.

Kërkesat e pranuar në Drejtorinë e Kadastrit, mars 2017	Numri i përgjithshëm i kërkesave	Të miratuara	Të refuzuara	Në procedurë	Mjetet e grumbulluara €
Certifikata të pronësisë dhe kopje të planit	3,285	3,285	0	0	16,077
Kërkesa për RDPP (regjistrimi i së drejtës për pronë të paluajtshme)	346	258	15	73	11,835
Kërkesa për historik, zyrtare, historik për persona fizikë dhe juridikë	26	26	0	0	240
Kërkesa nga Institucionet e ndryshme dhe përgjigjet nga Gjykata dhe	236	236	0	0	205

institucione të tjera - Shërbimi i RDPP-së					
Përmirësime në RDPP	58	47	3	8	1,160
Kërkesat për regjistrim të hipotekave	72	72	0	0	6,560
Kërkesat për çregjistrim të hipotekave dhe ndryshime	65	65	0	0	650
Ndarjet - parcelimet, copëtimet	28	22	0	6	1,998
Incizimi i ndërtesave, banesave	13	7	1	5	12,200
Bashkimi i parcelave	19	14	0	5	1,278
Dhënia e produkteve - pikave kadastrale (koordinatave)	66	66	0	0	1,496
Identifikimi i parcelave dhe njësive banesore	66	67	0	3	1,320
Përcaktimi dhe rirregullimi i kufirit të parcelave	16	11	0	5	600
Ndërrim i kulturës	2	2	0	0	6,720
Plotësim pagese - gjeodezi	10	10	0	0	196
Kërkesat me licencë	120	100	0	20	15,355

Kërkesa zyrtare nga institucionet - Shërbimi i gjeodezisë	40	33	0	7	81
Gjithsej	4,468	4,321	19	132	49,634

4.1.2 Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese

Drejtoria e Kadastrit nuk shpenzon buxhet për të regjistruar të drejtat pronësore në regjistrat kadastralë, përkundrazi, kjo drejtori realizon të hyra nga taksat e qytetarëve.

4.1.3 Takimet me palë

- **Sektori i kadastrit**, gjegjësisht Zyra për regjistrimin e pronës së paluajtshme (RDPP), ka takime të rregullta me palë, dy herë në javë (*e martë, e enjte*) nga 2 orë në ditë me dy zyrtarë ligjorë, ku ofrohen këshilla për plotësim të lëndëve sipas kërkesave të palëve. Brenda 2 ditëve, 2 zyrtarët e Zyrës për RDPP takohen me rreth 387 qytetarë.
- **Sektori i gjeodezisë** ka takime të rregullta me palë, ku gjatë muajit mars 2017 ka pranuar 292 palë për plotësim të lëndëve sipas kërkesave të tyre për ndarje, bashkim ose rregullim kufiri. Po ashtu ka takime me palë për identifikimin e banesave, si dhe takime të tjera me palë sipas kërkesave të tyre lidhur me çështjet pronësore.

5. Takimet me institucione të tjera

- **Sektori i kadastrit** - Takim me qytetarët për çështje të ndryshme kadastrale pronësore, për të cilat kemi zgjidhje ligjore ose i kemi udhëzuar palët që t'i drejtohen institucioneve të tjera në vend. Takim me AKP-në për disa përgjigje të kthyer nga kjo agjenci.

5.1.1 Diskutime publike/ takimet me qytetarë

- Nuk ka pasur.

6. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

6.1.1 Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër

- **Spektori i kadastrit:**
 - Lëndë të pranuar: 803
 - Lëndë të miratuara: 704
 - Lëndë të refuzuara: 18
 - Lëndë në procedurë: 81
- **Spektori i gjeodezisë:**
 - Lëndë të pranuar: 3,665
 - Lëndë të miratuara: 3,607
 - Lëndë të refuzuara: 1
 - Lëndë në procedurë: 51
 - Kërkesa nga muaji i kaluar: 4

7. Takime të tjera

- *Nuk ka pasur.*

8. SFIDAT - Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, psh. pengesa brenda drejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.

Spektori i kadastrit:

- Sfidues është komunikimi me institucionet, moskthimi i përgjigjeve nga ana e tyre në afate ligjore, të cilat na krijojnë probleme me palë dhe përfaqësues të palëve.
- 2 kërkesa presin për verifikime në Arkivin Komunal dhe Nderkomunal;
- 145 kërkesa presin për verifikim në Gjykatë;
- 14 kërkesa presin për verifikim në Privatizim;
- 23 kërkesa presin për verifikime në NPB;
- 39 kërkesa presin për verifikim në KPA;
- 2 kërkesa presin për verifikime në Drejtorinë e Financave dhe Pronës.

Sektori i gjeodezisë:

- Sfidues është komunikimi me Agjencinë Kadastrale të Kosovës, mosdhënia me kohë e përgjigjeve lidhur me problemet që hasim çdo ditë me programin “CadastralMap” dhe “SITK”, të cilat na krijojnë probleme me palë dhe përfaqësues të palëve;
- Mungesa e shënimeve në pjesën grafike, gabimet të cilat janë krijuar me rastin e rikonstruktimit të disa zonave kadastrale nga Agjencia Kadastrale e Kosovës.

9. **REKOMANDIME** - *Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve, nëse keni, dhe nevojave të Drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtoreve, furnizim me pajisje shitesë etj.*

Sektori i kadastrit:

- Trajnime për punëtorë sa i përket administratës dhe funksionimit të saj.

Sektori i gjeodezisë:

- Trajnime për punëtorë sa i përket aplikimit të kornizës së punës.

10. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES

-Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues

Sektori i kadastrit:

- Lëndët në shpallje publike në afat prej 5 ditë pune;
- Lëndët në KPA për pëlqime për regjistrim të banesave;
- Lëndët për verifikim në gjykata, NPB, AKP, Arkiv Komunal ose Ndërkomunal.

Sektori i gjeodezisë:

- Shqyrtimi i kërkesave për ndarje të pronësisë;
- Shqyrtimi i kërkesave për dhënie e produkteve (koordinatave);
- Shqyrtimi i kërkesave për bashkim të parcelave;
- Shqyrtimi i kërkesave për identifikimin e njërive banesore;
- Shqyrtimi i kërkesave për përcaktim dhe ri-rregullim kufiri;
- Shqyrtimi i kërkesave për gjeodetët apo kompanitë e licensuara;
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve.

11. *TË TJERA - Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.*